

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Jelena Krivokapiq, kryetare, Emine Kaçiku dhe Isa Kelmendi, anëtare, në çështjen juridike të paditësit M. B. nga .., të cilin me autorizim e përfaqëson Gj. D., avokat në .., kundër të paditurës S. B. nga .., të cilën me autorizim e përfaqëson M. B., avokate në ..., për anulim të kontratës për dhurimin, vlera e kontestit 3.100€ duke vendosur përkitazi me revizionin e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AC.GZ nr.3624/2015 datë 29.08.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.01.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AC. nr.3624/2015 datë 29.08.2017 me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C nr.885/2008 dt.07.05.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr.3624/2015 dt.29.08.2017, është refuzuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.885/2008 dt.07.05.2015 me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për anulimin e kontratës për dhurimin e paluajtshmërisës, e lidhur në mes të dhuratëdhënësit, tani të ndjerit Emin Bajrami nga Prishtina dhe dhuratëmarrëses, të paditurës S. B., e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë nën shenjen VR.(Ov.) nr..., dt..., përkitazi me paluajtshmërinë e evidentuar me numër ..., ZK ..., ngastra kadastrale P-..., në vendin e quajtur ‘Matiqanski Potok’, me kulturë arë e

klasës së IV në sipërfaqe prej 0.25,90 ha. Në paragrafin II, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit se ai është pronar në bazë të trashëgimisë i pjesës ideale $\frac{1}{2}$ të paluajtshmërisë së evidentuar sipas Çertifikatës së njësisë kadastrale ..., ZK ..., ngastra kadastrale P-..., në vendin e quajtur 'Matiqanski Potok', me kulturë arë e klasës së IV në sipërfaqe prej 0.25,90 ha, dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia pranoj të drejtën e pronës në pjesën ideale prej $\frac{1}{2}$ të paluajtshmërisë me shënime kadastrale si më lartë të paraqitura, dhe të pranoj e njëjta që pranë Drejtorisë së gjeodezisë në Prishtinë, të regjistrohet në emër të tij. Në paragrafin e III është anuluar masa e përkohshme e sigurimit E nr.254/2008 dt.09.04.2008 ndaj të paditurës S. B., me të cilën asaj i është ndaluar ngarkimi dhe shitja e paluajtshmërisë-ngastra kadastrale ..., në sipërfaqe prej 2590 m² e cila evidentohet në fletën poseduese ..., e që gjindet në vendin e quajtur 'Matiqanski Potok' në ZK ...

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit paditësi ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni i tij të pranohet, ashtu që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe të miratohet kërkesëpadia e paditësit, apo të njejtit të prishen dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

E paditura, përmes së autorizuarës së saj ka dhënë përgjeigje në revizion duke propozuar që i njejtë të hidhet si i palejuar, konform nenit 211 pika 2 dhe 3 të LPK, pasi që vlera e objektit të kontestit nuk e kalon shumë prej 3.000€, dhe njëkohësisht të aprovohet kërkesa e saj, që të kompenzohet dhe të detyrohet paditësi ti paguaj shpenzimet e procedurës sipas specifikimit të bashakangjitur me ankesë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës.

Duke vlerësuar aktgjykimin e kontestuar në bazë të nenit 215 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi i ka përfshirë si të paditur në këtë kontest S. B. dhe E. B., por që procedura ndaj këtij të fundit është ndërprerë pasi që ai në ndërkohë ka vdekur, ndërsa procedura më pas ka vazhduar kundër të paditurës S. B., përkitazi me anulimin e kontratës dhe vërtetimin e pronësisë në paluajtshmërinë e të paditurës. Në padi thuhet se kontrata mbi dhurimin, e lidhur në mes të (tani të ndjerit) E.B. dhe S. B., është e paligjshme dhe se ai (paditësi) është pronar i kësaj paluajtshmërie, por nuk ka mundur të hyj në posedim dhe shfrytëzim të saj, pasi e paditura Sulltane këtë paluajtshmëri ja ka shitur dikujt tjetër.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se Emin Bajrami djalit të tij i ka dhuruar vetëm paluajtshmërinë nga ngastra tjetër, por jo edhe paluajtshmërinë e cilën ia ka dhuruar bashkëshortës së tij-S. B., e regjistruar si ngastër kadastrale ..., që ka pasur sipërfaqen e tërësishme prej 0.41,90 ha, ndërsa paditësit i është dhuruar paluajtshmëria në sipërfaqe prej 0.44.36 ha. Paditësi ka bërë përpjekje që edhe ngastra të tjera ti bëjë pjesë të kontratës së dhurimit, dhe për shkak të këtij veprimi ai është shpalluar fajtor për veprën penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë, sipas aktgjykimit penal me numër P ... Në këtë vendim është thënë se me datën 10.03.2006 ka vënë në lajthim punëtorët e autorizuar të Gjykatës Komunale në Prishtinë për të vërtetuar në çështje të pavërtetë, në bazë të kontratës mbi dhurimin, me VR.nr..., ku kanë qenë të përfshira edhe ngastrat në ..., dhe ..., të cilat babai i tij në vitin 2000 ia ka shitur të dëmtuarit F. V., E njëjta gjykatë ka konstatuar se është anuluar pjesërisht kontrata e paditësit me babain e tij, me aktgjykimin e formës së prerë C nr.859/2006 dt.30.12.2008, lidhur me ngastrën kadastrale ..., ..., dhe ... Për këtë arsye, Gjykata Themelore ka refuzuar kërkesëpadinë, e që është vërtetuar nga ana e Gjykatës së Apelit e cila pastaj e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instances më të ulët, duke e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë i kanë zbatuar edhe dispozitat e procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Të dy aktgjykimet përbajnë arsye të mjaftueshme dhe janë vlerësuar të gjitha faktet në këtë çështje juridike të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Qendrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, si të rregullt dhe të bazuar në ligj e pranon kjo Gjykatë, ngase vendimet e goditura nuk janë përfshi me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 (pika 'n' dhe 'o') të LPK, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zurtare, e në të cilat thirret paditësi - kjo për faktin se në rastin konkret nuk ka tejkalim të kërkesëpadisë së tij, meqenëse gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë ka vendosur me 20.03.2014, e nga ana tjetër aktgjykimi i goditur është i qartë, i kuptueshëm dhe i arsyetuar drejtë.

Po ashtu, kjo Gjykatë konsideron se gjykatat e instancës më të ulët gjatë vendosjes drejtë kanë zbatuar dispoziten ligjore nga neni 111 të LMD lidhur me nulitetin e kontratës mbi dhurimin ku thuhet se kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, ku gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të aplëve, si dhe kur kjo gjë i është caktuar me këtë ligj ose me dispozitë të veçantë. Në rastin konkret nuk ka pse të anulohet, sepse nuk ekziston asnjë arsye nga neni i përmendur për anulim të kontratës. Sa i përket pretendimeve të paditësit se mbi bazën e trashëgimisë i takon pjesa ideale $\frac{1}{2}$ në paluajtshmërinë që i është dhuruar-është i pabazuar, për faktin se kthimi i dhurimit vlen për të gjithë trashigimtarë, pra edhe për paditësin të cilit babai i tij i ka dhuruar një pjesë të paluajtshmërisë në bazë të kontratës për dhurimin.

Kjo Gjykatë pati parasysh të gjitha pretendimet tjera në revizion, por që të njëjtat u treguan të pa sikseshme në vendosjen ndryshe të kësaj çështje kontestimore.

Sa i përket pretendimit i të paditurës se padrejtësisht nuk i janë pranuar shpenzimet e procedurës kontestimore konsiderohet si i pabazuar, meqenëse i autorizuari i të paditurës nuk e ka parashtruar specifikimin e shpenzimeve në procedurën e gjykimit në shkallë të parë të parashikuar në nenin 463.1 LPK. Përveç kësaj, kërkesat për kompensimin e shpenzimeve, në përgjegje në revizion janë të palejuara.

Po ashtu, kjo Gjykatë i ka vërejtur disa gabime (teknike) në numra të shënuar në dispozitivin e aktgjyqimit të shkallës së parë, mospërputhshmëria e numrave të ngastrave kadastrale, ata të shënuar në rendin e gjashtë dhe të nëntë të dispozitivit, mirëpo pa ndonjë ndikim negativ, pasi që gjendja në librat kadastrale mbetet ajo ekzistuese. Vlen të ceket që gabimet në emra dhe numra mund të korigjohen me aktvendim të posaçëm, sipas nenit 165.1 të LPK.

Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr.246/2017 më 24.01.2018

Kryetarja e kolegjit

Jelena Krivokapiq

Përktheu: Ferid Abazi